

Viti XIII, numri 2/sbkurt 2009

# FOREVER



HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA



# 2008 ishte një vit i shkëlqyer!



Është një kënaqësi e madhe që jemi më të fortë se kurdo. Kriza ekonomike prek seriozisht çdo fushë, kurse ne jemi me fat, rritemi dhe kemi sukses. Është fantastike që si rezultat i angazhimit, punës dhe përpjekjeve tona të përbashkëta tregojmë rritje në çdo rajon të Forever-it. Zhvillimi natyrisht përbën edhe sfidë, në fund të vitit të kaluar bëmë edhe një radhë emërimesh.

**T**a fillojmë radhën me Afrikën. Deri tani drejtimi i tregut afrikan ndodhej në dorën e Gregg Maughan. Gregg me angazhimin dhe energjitë e tij të pashtershme e lulëzoi tregun afrikan me një rezultat të lartë duke bashkëpunuar me drejtorët gjeneral. Por siç tha Gregg: "Ka ardhur koha t'ia jap dikujt tjetër drejtimin e tregut afrikan në mënyrë që t'u kushtoj më shumë energji çështjeve që prekin gjithë botën." Ai që morri tregun afrikan ishte **Gary Shreeve**, i cili para kësaj ishte drejtor marketingu i kompanisë sonë, kurse para kësaj drejtor rajonal në Houston të Teksasit. Me punën e tij të ndërgjegjshme dhe marrdhëniet e ngushta me distributorët drejtonte një nga rajonet më të suksesshme të

Amerikës Veriore. Di gjithçka rreth biznesit tonë, Forever Afrika do të jetë përsëri në duart të sigurta. I urojmë Gary-t gjithë të mirat dhe e përgëzojmë për emërimin e tij si drejtor i Afrikës.

Shpallim me kënaqësi emërimin e **Jackson Adagala** në postin e drejtorit operativ të Afrikës. Para kësaj ishte kryellogaritari i rajonit të Afrikës Lindore të FLP-s, shumë vetë mund ta njohin nga Rally Afrikan i vitit 2008 në Nairobi, ku ishte një nga drejtuesit e programit. Jackson në të ardhmen bashkë me Gary-n do të ndihmojë punën e vendeve afrikane. Përgëzime Jackson, të urojmë punë të mbarë!

Nga të sipërpërmendurat del qartë se zyra jonë e marketingut ka nevojë

për përforsim. Përgëzojmë drejtorin e ri të marketingut në familjen e Forever-it, **Paul Muehlmann**. Paul punon prej shumë vitesh në degën e MLM-s, zotëron përvoja të shumta në fushën e brand management dhe shfaqjes në Internet. I urojmë suksese të shumta!

Jemi gjithashtu tepër entuziast që shpallëm emërimin e **Dave Hall** në postin Senior Vice President të financës. Dave është prej vitesh të tëra anëtar me vlerë i skuadrës sonë, i urojmë gjithë të mirat në punën e tij, gjatë të cilës drejton dhe mbështet punën e gjithë vendeve, duke përfshirë edhe grupin Forever Resorts të Afrikës së Jugut.

Por Dave s'është Vice President i vetëm i cili u bë Senior Vice President. U emërua



**Gary Shreeve**



**Dave Hall**



**Scott Gold**



**Jackson Adagala**



**Carl Zander**



**Matt Harvey**



**Paul Muehlmann**



**Yves Hamon**

edhe **Carl Zander** i cili punon prej vitesh të tëra si anëtar i drejtorisë, ai u bë Senior Vice President i shitjes në Amerikë. Carl ka drejtuar prej vitesh punën e drejtuesve rajonal të Amerikës Veriore. Me këtë emërim puna e Carl-it në të ardhmen do të mbulojë gjithë tregun amerikan.

Dëshiroj t'ju prezantoj **Yves Hamon** si anëtare e re e drejtimin të Forever Europës. Yves ka punuar prej vitesh të tëra si drejtoresh financash në qendrën e Forever-it të Francës. E përgëzojmë për emërimin e saj në postin e drejtueses së auditit të brendshëm të Europës. Nën drejtimin

e Dave Hall do të drejtojë auditin e brendshëm të vendeve të Forever Europës.

Si përfundim shpallim me krenari se edhe Forever Resorts pësoi një rritje të konsiderueshme në vitin 2008. Përhëndesim Vice Presidentët rajonal, **Scott Gold dhe Matt Harvey**, në postin e tyre të ri. Të dy punojnë prej shumë vitesh si General Manager në Mormon Lake Lodge dhe Fun Country Marine, dhe janë gati për sfidat e reja.

Që nga fillimi detyra jonë kryesore është t'ju sigurojmë shëndet dhe mirëqenie Juve, distributorë. Grupi i distributorëve në më shumë se 135 vende sot arriti numrin prej 9.25 milion personash. Ju falenderojmë të gjithëve që mund të punojmë akoma së bashku që ta ndajmë me sa më shumë njerëz mundësinë e një jete më të shëndetshme e më të lumtur që na ofrojnë produktet dhe biznesin ynë i shkëlqyer.

Me respekt të pafund,  
**REX MAUGHAN**

*Dr. Sandor Milesz*

Gjatë punës sonë të përditshme takohemi shpeshherë me pyetjen nga ana e punonjësve fillestarë apo të interesuarve që a funksionon me të vërtetë sistemi ynë marketing, dhe sipas nesh a do të funksiononte edhe në rastin e tij?



# Plani marketing aktual

**S**i çdo pyetjeje, edhe kësaj duhet t'i përgjigjemi me kujdes. Duhet të japim përgjigje të thjeshtë dhe natyrisht duhet ta shpjegojmë në mënyrë të kuptueshme se përse i përgjigjemi kësaj pyetje me PO!

Mund të radhisim me qindra, mijra, madje miliona shembuj nga bota e Forever-it, ku është fakt që sistemi ynë funksionon, majde në mënyrë të shkëlqyer, dhe që punonjësi i ardhshëm ka në dorë një nga mundësitë e botës.

Si mund të binedemi rreth asaj që ky është me të vërtetë një sistem i përkryer, i përpunuar dhe zhvilluar për vite me radhë. Ne njerëzit i besojmë më shumë syrit, vetëm nëse e shikojmë themi se kjo ekziston me të vërtetë.

Vendi i shkëlqyer i prezantimit të sistemi tonë marketing aktual është Dita e Suksesit. Ky është vendi ku takohen pa e njohur aspak njëri-tjetrin punonjësit e grupeve të ndryshme, ata që së bashku ndërtojnë një diçka të madhe, shoqërinë Forever, një sistem marketing madhështor dhe gjigand. Në këtë ditë një distributor mund të takohet me punonjësit e skuadrave të tjera që ndodhen në të

njëtin nivel dhe mund të shikoj me sytë e vet dhe të bindet se çdo muaj kualifikohen me mijëra distributor në nivelin e parë të sistemit marketing, në nivelin e asistent menaxherit. Në radhë të gjata gjarpëruese marrin medaljet e tyre nga drejtori gjeneral, përgatisin një fotografi dhe punonjësit e tyre festojnë përreth skenës.

Është një mbresë e paharrueshme për shumë njerëz në një shoqëri ku vlerësimi moral pothuajse nuk njihet, ndoshta ekziston vetëm në familje ku prindërit lavdërojnë fëmijët e tyre për një veprim të mirë, apo anëtarët e familjes njëri-tjetrin për përgatitjen e një dreke të shijshme ose për organizimin e një ekskursioni të bukur familjar.

Asistent supervisorët tanë në Ditën e Suksesit marrin një pamje rreth funksionimit të sistemit marketing në zhvillimin e tyre personal, pasi të gjithë e dëshirojnë nivelin e ardhshëm të supervisorit, dhe nga muaji në muaj shohim me dhjetra supervisorë në skenë.

Punonjësit mbërrijnë në skenë të armatosur me lule e dhurata në mes të festimit të anëtarëve të skuadrës së tyre dhe të tjerave. Një ndjenjë e mirë dhe e paharrueshme. Ata që s'e kanë shijuar akoma

i presim me gjithë kënaqësi në Sukses Day-n e ardhshëm. Do të përjetojnë një mbresë të paharrueshme, është një ndjenjë shumë e mirë të qëndrosh në skenë mes duartokitjeve. Përse punojnë artistët, këngëtarët, yjet e rrokut? Pikërisht për këto duartokitje, vlerësim, brohoritje dhe lot gëzimi!

Është një ndjenjë e mirë për të gjithë të ngjitesh në skenën e lavdisë. Ky është një hap të cilin do ta kujtojë gjithë jetën, madje rreth kësaj do t'u tregoj fëmijëve, nipërve dhe miqve të tij – dhe mëtej me qindra e mijra asistent menaxher, menaxher dhe menaxher drejtues ngjiten dhe kualifikohen vazhdimisht në skenë.

Sistemi marketing i ëndërruar dhe krijuar nga presidenti dhe drejtori ynë i përgjithshëm, **Rex Maughan**, bëhet realitet në skenë. Bëhu edhe ti pjesë e kësaj mrekullie, bindu rreth faktit se kjo funksionon edhe në rastin tënd, vepra për të, ndrysho mendimet, merr vendimin dhe shijo suksesin në skenë.

Përpara FLP Hungari!

**DR. SANDOR MILESZ**  
drejtor gjeneral

# International Super Rally



**7-9 gusht 2009**

**Dallas, Texas**

Ndërkohë që të kualifikuarit e vitit të kaluar vizituan Zyrën Qendrore në Scottsdale të Arizonës, të kualifikuarit e sivjetshëm mund të shikojnë fabrikën e re Aloe Vera of America dhe janë të ftuar në të famshmin Southfork Ranch që është pronë e Forever Resorts. Takohemi në 2009-ën në Super Rally-n e Dallasit!



## SILVER POST RALLY TOUR

Ju njoftojmë me kënaqësi se Silver Post Rally i 2009-ës do të organizohet në Lake Tahoe-n e mrekullueshëm. Strehimi i të kualifikuarve bëhet në Montbleu Resort, i cili përmban një banjë termale lluksoze, 6 restorante, 4 vende argëtimi elegante, si dhe një kasino të rinovuar me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup>. Liqeni Tahoe ndodhet shumë afër. Ekzistojnë mundësi të ndryshme shplohjeje: alpinizëm, golf, kalorësim, shëtitje me biçikleta, me varkë, me anije me vela, me kanoe, peshkim, wakeboard. Këtu secili gjen mundësi argëtimi! Vetëm duhet të arrish 2500 cc gjatë periudhës nga 1 prill 2008 deri në 31 mars 2009. Shpresojmë të takohemi në gusht.

2009 Lake Tahoe

# Rëndësia e ndërtimit të skuadrës **së përbashkët**



Skena e Arenës u sundua nga një atmosferë festive kur me meloditë e këndshme të kitarës së **Leslie**-t filloi dita e suksesit të dhjetorit.





**V**iolinisti **Zoltan Maga** verdhi me rastin e festës që ta përshëndeste vitin e ri bashkë me Forever-in.

Me drejtimin e shkëlqyer të **Csaba Juhasz** dhe **Enikó Bezzeg** dhe pjesëmarrjen e 5000 punonjësve tanë filloi aktiviteti ynë tradicional i mbylljes së vitit.

Natyrisht s'mungonte as Plaku i vitit të ri falë senior menaxherit **Laszlo Hari** dhe familjes së tij.

Drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** në përshëndetjen e tij përmbyllëse të vitit theksoi rëndësinë e ndërtimit të skuadrës së përbashkët

dhe falenderoi anëtarët e President's Club të vitit 2008 për angazhimin dhe veprimtarinë e tyre të madhe dhe tepër aktive.

Diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics** prezantoi qartë rëndësinë e Business, programit të ri motivues të ndërtimit

të biznesit, i cili e rinovon dhe ndihmon në mënyrë të jashtëzakonshme veprimtarinë e rrjetndërtuesve tanë.

Senior menaxherja **Dr. Anna Schmitz** me maturinë e zakonshme dhe përvojën e saj të madhe prezantoi produktet e reja të kompanisë





sonë Aroma Spa Collection dhe sapunin Avocado. Prej vitesh të tëra është traditë që në ditën e suksesit të krishtlindjeve soaring menaxherët **Dr. Terezia Samu** dhe **Andras Bruckner** bisedojnë me fëmijët rreth mënyrës se si hyjnë produktet tona në botën e tyre të vogël, sa u pëlqejnë këto produkte dhe marrim opinione të sinqerta dhe serioze, ndonjëherë gazmore nga fëmijët tanë. Falenderojmë fëmijët dhe natyrisht prindërit e tyre për bashkëpunimin.

Në skenë erdhi kualifikimi i supervizorëve të rinj i cili është elementi më i rëndësishëm i ditës së suksesit. **Supervizorët** sipas zakonit u ndoqën nga asistent menaxherët të cilët morrën nga drejtori gjeneral medaljen që përbënte vlerësimin e tyre, ndërkohë që festonin mes duartrokitjeve të mëdha në skenë.

Menaxherja **Tasnadi Lajosne Ilike** na shkaktoi surprizë me energjinë, forcën dhe të ardhmen rinore që shikon në biznesin tonë. Këmbëngulja dhe rendimenti i saj është shembullor, dhe shpresojmë që nga ajo s'mëson vetëm brezi i saj. Ndërmjet të kualifikuarve

të nëntorit të **Klubit të Sundimtarëve** në vend të parë doli safir manaxheri **Mikulas Vareha**.

Pasj kësaj në skenë erdhi marrja e madaljeve dhe prezantimi i shkurtër i menaxherëve të rinj. Natyrisht pasoi edhe vlerësimi i të **kualifikuarve të progra-**

**mit motivues të makinës,** i përgëzojmë pronarët e makinave të reja.

Si senior menaxher **Endre Tordai** dhe **Irma Szep Tordaine**, kurse si soaring menaxher **Tamas Budai** morrën medaljet e merituar dhe përhëndetën sponsorët dhe skuadrën e tyre për











ndihmën e marrë në arritjen e këtij rezultati fantastik. Falë **Attila** dhe **Kata Gido-falvi**-t në skenën e Forever-it u shfaq për herë të parë një pamje e re të ardhmeje dhe një pikëpamje e re në Forever.

Nga leksioni i tyre rrezatoi një profesionizëm, siguri dhe angazhim i pafund të cilin punonjësit tanë e dëgjuan me shumë vëmendje dhe e shpërblyen me duartrokitje të mëdha. Përgëzime për leksionin e suksesshëm!

**Lilla Polyak** i magjepsi me zërin e saj të mrekullueshëm pjesëmarrësit e Sitës së Suksesit dhe e bëri të paharueshme këtë ditë.

Senior menaxherja **Tünde Hajcsik** me idetë e krishtlindjeve ndihmoi punën shitëse të punonjësve tanë. Nga leksioni i saj tepër i hollësishëm mësuam shumë imtësi dhe marifete rreth mënyrës se si mund të bëhemi akoma më të suksesshëm.









Lektori i pavarur **A.J. Cristian** na i shpjegoi në një mënyrë të re thelbin e komunikimit dhe krijimit të marrdhënieve.

Ditën e fundit të suksesit të vitit 2008 të Forever Living Products të Hungarisë e mbyllëm me kualifikimin e **asistent supervisorëve**, i cili është një nga hapat më të rëndësishëm në rrugën e plotësimit të vetes sonë.

# NDJENJA – VLERA



Çfarë përbëjnë për mua këto fjalë? Nëse dua të shprehem shkurt: gjithçka. Por s'është e lehtë të ruash vlerat e ndjenjave në këtë botë materialiste. Por ta shohim pak më gjerë.

gjithmonë e më shumë dhe u bëra me blerës dhe punonjës për të cilët mbaja përgjegjësi. Rruga duhet treguar. Çfarë ndjenje është? Kur fëmija fillon të ecë dhe e pëlqen atë me gjithë vështirësitë e saj. Edhe nëse bie disa herë në tokë, ngrihet përsëri dhe ecën mëtej. Ndërkohë m'u bë e qartë se po eci në rrugën e duhur, kjo është RRUGA IME gjithashtu!

Është interesante përshkrimi i kësaj rruge! S'do t'ua përcillja dot në mënyrë të qartë dhe të besueshme përvojat punonjësve të mi nëse s'do e përshkoja deri në fund këtë rrugë, sepse çdo përvojë dhe punonjës është ndryshe. Secili e kupton ndryshe FLP-n dhe kërkon tjetër gjë në FLP. Kam punonjës për të cilin gjëja më e rëndësishme është t'i tregojë mjedisit të tij se ai është një person i pavarur që përfaqëson vlera. Ka nga ata që drejtohen nga qëllimet dhe gjetja e vetvetes. Dhe ka nga ata që u pëlqen fakti që këtu merremi me njëri-tjetrin dhe është i rëndësishëm personaliteti dhe puna e tij. Do të radhisja shumë shembuj të tjerë, por mendoj se edhe ti e kupton se çdo të thotë kur them ndjenja – vlera. Dhënia e ndihmës për gjetjen e këtyre rrugëve është një sfidë e vërtetë. Dhe gjithë këtë ta bësh duke mos qenë epriori i askujt, por drejtuesi i tij! Kjo është një detyrë e mrekullueshme!

Dhe s'kam përmendur akoma anën materiale, ndërkohë

që edhe kjo përbën vlerë, pasi është mjeti i ekzistencës sonë. Kemi nevojë për të në jetën e përditshme. Në këtë profesion mund të arrish gjithmonë dy gjëra, vlerësimin material dhe zbulimin e vetvetes. Madhështia e këtyre kapërcen çdo imagjinatë, por përmasat e asaj që ëndërrojmë për vetveten dhe sa bëjmë për të, kjo varet vetëm nga ne.

Dhe pavarësisht se u rrita në një familje – falë prindërve të mi – ku ndjenja përbën vlerë, dhe primare është të japim dhe të ndihmojmë të tjerët, në vendet e mëparëshme të punës filloi të më zbehej pak kjo pikëpamje.

Falenderoj **Beata Tasnady**-n që me diturinë dhe durimin e saj të pafund ma hoqi këtë perde nga sytë duke e bërë më të qartë shikimin tim. E falenderoj edhe për faktin që më tregoi se ekziston një vend pune ku rëndësia e familjes qëndron krahas zhvillimit dhe krijimit të sigurisë materiale.

Si përfundim mos harro kurrë!

**„Ajo që ndodhet prapa dhe përpara teje, s'është asgjë në krahasim me atë që ndodhet brenda teje.”**

(Robin Sharma)



**TÜNDE GOMBOS ANTALNE  
DHE ANDRAS ANTAL**

asistent menaxherë

**Q**ë kur jam distributore e pavarur e kësaj firme mendohem shumë për fjalitë dhe shprehjet të cilat më parë s'më pëlqenin, s'i kuptoja, apo s'merrja mundimin t'i kuptoja dhe t'i mendoja deri në fund. Meqë ne (që punojmë këtu) i përrjetojmë në disa vite rrethanat e punës të cilat të tjerët i përrjetojnë në 40 vjet, kemi shumë gjëra për t'u meditar. Jam me fat, pasi mund të takohem me njerëz me vlera dhe fate të ndryshme, kështu që kam nga të marr përvojë.

Si pedagoge në shkollë e kam mësuar se detyra ime si mësuese është të gjej rrugën drejt çdo fëmije, pasi çdo krijesë e vogël është ndryshe. Ka rrugë drejt secilit prej tyre, varet vetëm nga zotësia, humanizmi dhe dituria ime që a e gjej atë. Kështu funksionon edhe me të rriturit, vetëm jo kaq qartë. Shtegjet që të çojnë drejt tyre në disa vende janë mbyllur nga bimë që s'e kanë

aty vendin. Si sponsor kam të njëjtën detyrë! Të gjej rrugën drejt punonjësve duke mos kaluar kufirin e ndërgjegjjes, sinqeritetit dhe ndershmërisë!

Edhe rruga që të çonte drejt meje s'ishte e thjeshtë dhe e shkurtër. Duhet të rrezoheshin muret e ndërtuara prej meje që të dalloja përsëri forcën, diturinë dhe dashurinë time për vetveten. Çfarë ndjenjash m'u çliruan? Ke parë fëmijë të vogël që gëzohet kur sheh prindërit? Kur i shfaqet në fytyrë gëzimi dhe njohja që ata janë prindërit! Dhe buzëqesh. Tek mua kjo njohje s'u bë për një moment, por sot buzëqesh në shpirt. Çfarë më çoi përpara? Fillimisht produktet më dhanë forcë që pas operacionit të shtyllës kurrizore të ngrihem prapë në këmbë dhe të bëhem përsëri njeri i plotë. Pastaj në jetë kisha faza kur rrethanat më bënë të dyshoj në lidhje me biznesin, pavarësisht se të tjerëve u funksiononte. Çfarë më çoi përpara në biznes? Mësova

## HOTELI KËSH TJELLA E SZIRAKIT



### OFERTË SPECIALE 2009

**Dy netë në dhomë me dy krevate në ndërtesën kryesore:** 21.320 Ft/person në vend të 26.500 Ft/person

**Tre netë në dhomë me dy krevate në ndërtesën kryesore:** 31.980 Ft/person në vend të 39.750 Ft/person

**Dy netë në dhomë me dy krevate në ndërtesën në krahë:** 15.550 Ft/person në vend të 19.900 Ft/person

**Tre netë në dhomë me dy krevate në ndërtesën në krahë:** 23.330 Ft/person në vend të 29.850 Ft/person

Çmimet përmbajnë mëngjesin, përdorimin e saunës, kabinës së kripës, pishinës dhe xhakuzit.  
Në restorantin tonë të klasit I (i cili është hapur në orarin 12:00 – 20:00) jepet mundësia e ushqimit a la carte dhe ditor të hotelit.

Çmimi i gjysëm shërbimit është 3.900 Ft/person/ditë, kurse i shërbimit të plotë 7.600 Ft/person/ditë.

#### **Shërbime të tjera:**

solar, floktore, kozmetikë, masazh, fushë bowlingu, sallë lojrash.

*Për distributorët e FLP-s këto shërbime janë me 50% ulje.*

*Për përdorimin e shërbimeve tona duhet bërë kërkesë paraprake.*

***Shpresojmë që oferta jonë t'ju pëlqejë dhe të na respektoni me vizitën tuaj!***

#### **HOTELI KËSH TJELLA E SZIRAKIT**

3044 Szirák, Petőfi út 26.

Tel.: +36-32-485-300, +36-32-485-117

E-mail: [kastelyszirak@globonet.hu](mailto:kastelyszirak@globonet.hu)

# Biznesi më premtues

Në datën 04. 12. 2000, të shtunën organizuam takimin tonë të parë të FLP-s në Bijelinë. Vitet e kaluara kaluan menjëherë. Edhe tetë vjet pas takimit tonë të parë e organizuam të shtunën Ditën e Suksesit. Më 06. 12. 2008 në të njëjtën sallë u takuam me të njohur dhe miq të vjetër, si dhe me shumë fytyra të reja.



**K**ujtuam bashkëpunonjësin tonë safir menaxher **Cvetko Ratković** i cili u përkiste më të mirëve, por tani fatkeqsisht s'ndodhet më mes nesh. Ishte një njeri me vullnet, i ndershëm, fjalëpaktë dhe shpirtmadh. Na mungon shumë të gjithëve. Mendojmë me respekt dhe falenderim për të. E tillë është jeta – shpeshherë na jep, por me raste edhe na merr. Pavarësisht nga kjo s'duhet të lëkundemi, punën duhet ta kryejmë me më shumë forca dhe vendosmëri.

Aktivitetin tonë u drejtua me shumë përkushtim dhe zell nga **Meliha Dragić** dhe **Gaibija Čatić**. Krijuan një atmosferë të veçantë nga fillimi deri në fund.

Këtë e vlerësuan shumë edhe distributorët tanë të cilët s'ishin shfaqur kurrë në një numër kaq të madh në Bijelinë.

Drejtori rajonal i Bosnias **Dr. Slavko Paleksić** përshëndeti drejtorët rajonal të pranishëm dhe foli rreth tetë viteve të kaluara në vendin tonë. Tha se asgjë s'ka ndryshuar: produktet janë të shkëlqyera, Plani Marketing i Rex-it është i mrekullueshëm, e respektojmë politikën e biznesit të kompanisë sonë, shpërblimet vijnë rregullisht, çmimet e produkteve s'kanë ndryshuar dhe përveç kësaj kemi siguruar shumë miq të rinj, përvoja me vlerë dhe fytyra të qeshura. Me FLP-n jemi bërë njerëz më të mirë – mbylli





fjalën e tij përshëndetëse Dr. Paleksić.

Mysafiri ynë më i dashur, drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** tha se e mes nesh ndihet si në shtëpinë e vet. Në fjalën e tij përshëndetëse theksoi që kompania jonë funksionon në mënyrë të shkëlqyer në periudhat pa probleme dhe të vështira gjithashtu, dhe që me ndihmën e produkteve të reja dhe programeve motivuese kemi një zhvillim të palëkundur. Na përgëzoi për rezultatet tona, kurse të pranishmit e falenderuan me duartrokitje të gjatë pamjen e të ardhmes, drejtimin e Rex Maughan dhe Dr. Milesz dhe sukseset e përbashkëta të arritura me ndihmën e tyre.

E përshëndetëm dy herë në aktivitetin tonë grupin kërcimtar nga Bijelina „**Grupa 101**”. Gjatë shfaqjes së shkëlqyer publiku i prit me entuziazëm të madh anëtarët më të rinj të kësaj shkolle, sepse rinia rrezatoi forca të mëdha pozitive drejt shikuesve.

Senior menaxherja **Dr. Olivera Miškić** në leksionin e saj foli rreth ushqimit të duhur, higjenes së gojës dhe dhëmbëve, si dhe mënyrës se si mund të sigurojmë një buzëqeshje të bukur e reza-tuese dhe kushtet e nevojshme për një jetë të shëndetshme. Produktet tona ia rekomandon nga zemra kolegëve dentist dhe bashkëpunonjësve të saj.

E falenderojmë doktoreshën Miškić për leksionin e saj të vlefshëm e të këndshëm.

Soaring menaxheri **Boro Ostojić** flet gjithmonë me fjalë të ngrohta dhe të singërta rreth punës së tij. Boro s'ka patur një jetë të thjeshtë. Me një film të shkurtër tregoi se si humbi gjithçka gjatë luftës, dhe si jeton përsëri në mirëqenie. "Kam mjaft nga të gjitha, madje më tepër nga ç'duhet! FLP është biznesi i të ardhmes! Mos u dorëzo kurrë, por përgatit listën e emrave të miqve dhe të njohurve të tu, përpuno planin dhe këtë ide përcille tek sa më shumë njerëz. Me këtë brenda një kohe të shkurtër të shpërblehet puna

e investuar, madje shumëfish!" – tha në fund të leksionit. E falenderojmë për këtë leksion shumë motivues.

Punonjësit tanë mjek, zonjat shtëpiake, mësuesit dhe punonjësit tanë me profesione të tjera folën rreth përvojave me produkte të sigurura gjatë punës së tyre. Kjo pjesë e programit u drejtua nga menaxherja nga Bijelina **Sanja Ljubojević**, e cila theksoi se njerëzit i besojnë lajmet rreth nesh dhe se përvoja personale është më e mira.

Kompania jonë u siguron mundësi të njëjta gjithë punonjësve. Këtë e vërteton edhe shembulli i menaxheres **Zrinka Vraneš**. Zrinka e tre-





goi me fjalë të ngrohta dhe si nënë e vërtetë sekretin e suksesit. "Flisni rreth produkteve, por mos harroni të përmendni edhe mundësinë e përmirësimit të gjendjes materiale, sepse ato janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Jepuni shpresë punonjësve të rinj, udhëhiqini ata në punë, motivoni vepërimtarinë e tyre dhe tregojuni gabimet tuaja që ata të mos i kryejnë. Prezantojuni punonjësit e suksesshëm të cilët janë të shumtë në FLP. Unë pata besim tek bashkëpunonjësit e mi dhe pata sukses!" – mbylli fjalët e saj zonja e mrekullueshme nga Sarajeva.


Leksioni i shkëlqyer i senior menaxherit **Safet Mustafić** ngjalli mirënjohje të madhe

tek të gjithë edhe në Rally-n e Poreçit. Tregoi në mënyrë të qartë se si mund të arrijmë për një kohë të shkurtër nivelin supervisor dhe nivele edhe më të larta. Tregoi se si mund t'i trajtojmë pretekstet dhe si mund t'i mposhtim vështirësitë. Na tregoi rrugën që e çoi drejt sukseseve në FLP. "Familja ime jeton pa probleme falë FLP-s! Këtë mund ta siguronim edhe ju për veten dhe familjen tuaj!" – tha në fund të leksionit. Duhet ta besojmë sepse pavarësisht nga fati i tij jo i shkëlqyer mbetet shembulli i këmbënguljes, ndershërisë dhe suksesit. Arrij sa më shpejt nivele të reja kualifikimi! – i uruan Safet-it gjithë të pranishmit.

Senior menaxherja **Marija Nakić** në leksionin e saj foli rreth Planit Marketing dhe rëndësisë së arritjes së nivelit katër pikësh në çdo muaj. Theksoi se sukcesi pret të gjithë ata që e zbatojnë rregullisht politikën e biznesit dhe Planin Marketing të kompanisë sonë. Këtë e vërteton me karrierën e saj të suksesshme. U bë e qartë për të gjithë se si e arriti besimin e njerëzve të shumtë dhe zhvillimin e vullshëm të skuadrës së saj. E përgëzojmë nga zemra për leksionin e shkëlqyer!

Drejtesit e programit e prezantuan në këtë mënyrë diamant menaxheren **Veronika Lomjanski**: "Kujtuam se dinim gjithçka rreth Veronikës dhe Stevos. Gabuam. Ata e





tërheqin pa ndalesë vagonin e suksesit ku ne ulemi."

"Mos qëndroni pa bërë asgjë! Tërhiqeni edhe ju këtë vagon! Edhe ne me dy pikë e filluam dhe sipas nesh kemi arritur vetëm në fillim të rrugës. Falenderojmë Rex-in dhe Sandor-in! ne u bëmë të suksesshëm në kompaninë e mrekullueshme FLP sepse shfrytëzuam mundësitë e saj të shumta. Ne do të shkojmë përpara! Edhe ju mos prisni! Bashkohuni me ne! Ju pret vagoni juaj! Ngjiteti shpejt!" Kështu i motivoi Veronika të pranishmit. Faleminderit për gjithçka Veronika dhe Stevo!

U dhamë medaljet e merituar punonjësve të sapokuali-

fikuar dhe shpërblyem më të mirët. "Shqiponjat e vogla" të reja përfunduan në shumë duar. Urojmë që çdo shqiponjë të fluturoj sa më lart.

Shfaqja e **grupit „KUM i KUM”** u siguroi një argëtim fantastik të pranishmëve në Drina Hotel.

**DR. SLAVKO PALEKSIĆ**  
Drejtori rajonal i FLP Bosnies

FOTOGRAFOI: TOMIĆ

# Presidents' Club 2009



**Tibor Elias**

*Total CC 2158,847; Personal & Non-manager CC: 1631,298*

„Për qëllimet më të bukura, me skuadrën më të mirë, me informacionet më të vlefshme, me firmën më korrekte... S'ka kufi!

**Pavarësi – Siguri jetese – Para = kjo është FLP**



**Csaba Juhasz & Enikó Bezzeg**

*Total CC: 2865,464; Personal & Non-manager CC: 1506,934*

„Kjo është jeta jonë, për ne ky është mision.”



**Istvan Toth & Marta Zsiga**

*Total CC: 2351,846; Personal & Non-manager CC: 1406,187*

„Nëse dëshiron të jetosh ndryshe, duhet të veprosh ndryshe”



**Tünde Hajcsik & Andras Lang**

*Total CC: 1792,769; Personal & Non-manager CC: 1193,763*

„A FOREVER LIVING për ne është pavarësia e zgjedhjes. Ky emër do të thotë cilësi, e cila është e pranishme në çdo fushë të jetës sonë. Misioni ynë është t'ua përcjellim sa më shumë njerëzve këtë MUNDËSI!”



**Robert Varga**

Total CC: 5885,240; Personal & Non-manager CC: 1140,153

„Vlera e njeriut duket tek numri i njerëzve që shërben!”



**Miklos Berkics**

Total CC: 7411,206; Personal & Non-manager CC: 804,282

„Realizo gjithmonë më shumë se sa presin prej Teje.”



**Agnes Krizso**

Total CC: 5526,888; Personal & Non-manager CC: 734.798

„I përkasim kompanisë më të mirë në botë. Firma Forever Living Products na e shpërblen shërbimin që u ofrojmë të tjerëve. Jam e kënaqur dhe e lumtur që kjo detyrë m'u bë program jete.”



**Istvan Halmi & Rita Mikola Halmine**

Total CC: 4236,114; Personal & Non-manager CC: 893,353

„Thonë që e para është puna, pastaj vjen argëtimi. Ne themi që e para është familja, pastaj vjen puna, por kjo punë është argëtim!”



**Dr. Adolf L. Kosa**

Total CC: 4081,928; Personal & Non-manager CC: 1077,680

„Baba krenar i dy fëmijëve dhe drejtuesi i skuadrës më të mirë të FLP-s. Më parë punonte në TV, radio, si avokat, kurse tani është njeri i lirë.”



**Aranka Vagasi & Andras Kovacs**

Total CC: 3336,284; Personal & Non-manager CC: 618.359

„Ndezim qirinj, japim besim, jemi ndjekësit dhe shërbyesit e intelektit. Ky është besimi ynë.”

**Dragana Janović & Milos Janović**

Total CC: 1630,634; Personal & Non-manager CC: 768,818

„Dragana është ekonomiste, ka qenë këshilltarja ekonomike e ministrit të ekonomisë në çështjen e ekonomisë së jashtme, Milos është inxhinier mekanik, ka punuar në Frigostroj. Janë anëtarë të FLP-s vetëm prej vitit 2002. Jemi prej disa vitesh anëtarë të PC, si dhe të kualifikuar të Profit Sharing, Rally-t European dhe Super Rally-t. Kemi arritur nivelin II në programin motivues të makinës.”

**Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski**

Total CC: 5622,549; Personal & Non-manager CC: 727,967

„Të ndodhesh në President's Club është rezultat i punës së vazhdueshme, angazhimit dhe lojalitetit ndaj firmës e cila na ofron gjithçka. Për ne kjo është sfidë, motivim, nder dhe përgjegjësi e madhe si ndaj vetvetes, edhe ndaj atyre që na ndjekin.”

**Marija Nakić**

Total CC: 1336,452;

Personal & Non-manager CC: 1336,452

Është një nder tepër i madh për mua të jem anëtare e President's Club. Jam prej 11 vitesh konsumatore e rregullt e produkteve dhe punonjëse e angazhuar e FLP-s me kënaqësinë dhe dëshirën që këto produkte të shkelqyera të shkojnë në çdo shtëpi.

**Marija Buruš & Boško Buruš**

Total CC: 3103,088; Personal & Non-manager CC: 722,738

„KONSUMATORË TË KËNAQUR DHE PUNONJËS ME VLERË TË FLP-S!  
SPONSORË KRENAR TË NJË SAPPHIR TEAM TË SUKSESSHME!”

**Aleksandar Dakić**

Total CC: 112,930;

Personal & Non-manager CC: 112,930

Fillimisht dua të them se unë, si drejtor rajonal i Malit të Zi, i gëzohem shumë faktit që edhe Mali i Zi ka një anëtar të tij në President's Club të FLP-s. Anëtarësia ime në President's Club është nder dhe kënaqësi për mua edhe për shkakun që bashkë me kolegët e mi nga rajoni do i kryejmë së bashku detyrat që i përkasin anëtarësisë në President's Club. Me këtë rast dëshiroj të përshëndes Rex Maughan-in, Dr. Sandor Milesz-in, drejtorët e zyra të rajonit dhe anëtarët e President's Club.



**Jadranka Kraljić - Pavletić & Nenad Pavletić**

Total CC: 1109,445; Personal & Non-manager CC: 738,027

„Dimë ta shijojmë jetën, por vetëm sot me Forever-in mund të shijojmë edhe ditët.”

**Tihomir Stilin & Maja Stilin**

Total CC: 1825,540; Personal & Non-manager CC: 455,996

Senior menaxherët nga Rijeka me skuadrën e tyre të re të FLP-s – me vajzat e tyre Tea, Lea dhe Eni, si dhe bashkëpunonjësit e tyre, me ndihmën e të cilëve u bënë anëtarë prestigjioz të President's Club.

**Jozefa Zore**

Total CC: 1408,252; Personal & Non-manager CC: 688,76

Ishte e para në Slloveni dhe që atëherë e drejton në mënyrë shembullore skuadrën e saj e cila funksionon në mënyrë stabile prej tetë vitesh, gjë e cila tregon se ajo i mbështet me përkushtim dhe punë këmbëngulëse bashkëpunonjësit e saj.

**Tomislav Brumec**

Total CC: 1385,723 Personal & Non-manager CC: 388,287

Ishte ndjekësi i parë në Slloveni, i cili e ndërtoi biznesin me përkushtim dhe energji të madhe, dhe në rastin e tij është e vërtetë shprehja: Duke ndihmuar të tjerët ndihmon vetveten – sepse për atë i pari është njeriu, pastaj biznesi.

**Vaselije Njegovanović**

Total CC: 956,973; Personal & Non-manager CC: 226,458

„Senior menaxher nga Sarajeva. Distributori dhe manaxheri i parë i vendit tonë. Krijoi një biznes familjar, edhe vajza dhe djali i tij janë menaxher. Punon në shumë shtete, është i besueshëm dhe shumë aktiv në Ditët e Suksesit dhe seminare. Anëtar konstant i President's Club.”

**Meliha Dragić & Dragan Dragić**

Total CC: 426,287; Personal & Non-manager CC: 378,913

„E ndërtuan dhe zgjeruan mes rrethanave shumë të vështira rrjetin e tyre në Bosnie. Qarkullimi i tyre karakterizohet nga një zhvillim i vazhdueshëm dhe dinamik. Janë lojal dhe të përgjegjshëm, i ofrojnë një ndihmë të madhe FLP-s në organizimin e seminareve dhe prezantimeve. Anëtarë konstant të President's Club.”

# KLUBI I SUNDIMTARËVE

Dhjetë distributorët e parë të muajit dhjetor 2008 sipas pikëve personale dhe të non-managerit



## Hungaria

1. Rusák Patrícia
2. Tóth Csaba
3. Haim Józsefné dhe Haim József
4. Révész Tünde dhe Kovács László
5. Fekete Zsolt dhe Ruskó Noémi
6. Rusák József dhe Rusák Rozália
7. Szanyi Imre
8. Wehliné Mezei Aranka dhe Wehli Péter
9. Ádámné Szöllősi Cecília dhe Ádám István
10. Sulyok László dhe Sulyokné Kökény Tünde



## Serbia, Mali i Zi

1. Rakovac Radmila dhe Rakovac Budimir
2. Petrović dr. Aleksandar dhe Djuknić Petrović Mirjana
3. Munjas Aleksandra dhe Munjas Mile
4. Marić Vlastimir dhe Dr. Marić Višnja Vera
5. Miškić dr. Olivera dhe Miškić dr. Ivan
6. Tintar Ivona
7. Čoček Biljana dhe Čoček Aleksandar
8. Žurka Dragana dhe Žurka Radiša
9. Stevanović Verica dhe Stevanović Rade
10. Strboja Jovanka dhe Strboja Radivoj



# CONQUISTADOR CLUB



## Kroacia

1. Kraljić-Pavletić Jadranka dhe Pavletić Nenad
2. Dr. Molnár László dhe Dr. Molnár-Stantić Branka
3. Jurović Zlatko dhe Jurović Sonja
4. Brence-Jović Vesna dhe Jović Dušan
5. Orinčić Marija Magdalena
6. Calušić Dubravka dhe Calušić Ante
7. Miljak Rill Ivanka dhe Rill Rolf
8. Katić Ivan dhe Katić Mesaroš Mirjana
9. Grbac Silvana dhe Grbac Vigor
10. Banić Nedjeljko dhe Banić Anica

## Bosnia dhe Hercegovina

1. Ilijić Zdravka dhe Ilijić Filip
2. Varajić Savka
3. Medić Stana dhe Medić Bogdan
4. Varajić Zoran dhe Varajić Snežana
5. Marić Slavica
6. Njegovanović Vaselije
7. Šaf Ljiljana dhe Šaf Vladimir
8. Marković Danijel
9. Džaferović Dževad dhe Džaferović Albina
10. Lukač Ljubica



## Sllovenia

1. Smiljanić Petra dhe Smiljanić Marko
2. Jazbinšek Kim
3. Batista Ksenja
4. Božnik Slavica
5. Cvijanović Ana dhe Cvijanović Božidar
6. Novak Jožica
7. Zabkar Alain dhe Kević Zorana
8. Kuder Justina dhe Kuder Vinko
9. Polsak Alenka dhe Polsak Blaž
10. Lončarić Erika dhe Lončarić Franc

# CONQUISTADOR CLUB 2008



# Klubi i Sundimtarëve 2008



## Magyarország:

### Vareha Mikulas (Top Total 1607, 60 cc)

Juhász Csaba dhe Bezzeg Enikő  
Dr. Németh Endre dhe Lukácsi Ágnes  
Klaj Ágnes  
Olajos András  
Budai Tamás  
Oltvölgyiné Zsidai Renáta  
Farkas Gáborné dhe Farkas Gábor  
Major István dhe Majorné Kovács Beatrix  
Bánhidny András  
Gáspár József dhe Hegedűs Judit  
Kemenczei Vince dhe Tamási Krisztina  
Futaki Ildikó  
Molnár Zoltán  
Térmegi Lászlóné dhe Térmegi László  
Dr. Horváthné Ollrárn Tünde dhe Dr. Horváth István  
Senk Hajnalka  
Csillag Adrienn dhe Lányi Roland  
Veres Zoltán dhe Veresné Csernák Mónika  
Abuczki Attila dhe Abuczkiné Kiss Ágnes  
Tóth Róbert László dhe Tóth Róbert Lászlóné  
Dr. Rokonay Adrienne dhe Dr. Bánhegyi Péter  
Várad Eva  
Bodnár Daniela  
Rusák Patrícia  
Takács Andrea  
Hegedűs Ervin dhe Hegedűsné Ponyi Tímea  
Bársony Balázs dhe Bársonyné Gulyka Krisztina  
Futó Lászlóné dhe Futó László  
Mohácsi Viktória  
Balázs Nikolett  
Keneseiné Dr. Milics Margit dhe Kenesei Gyula  
Hollóné Kocsik Judit dhe Holló István  
Damásdi Ildikó  
Seres Máté  
Boskó Hilda dhe Boskó Béla  
Réfi Lászlóné  
Dr. Rédeiné Dr. Szűcs Mária dhe Dr. Rédei Károly  
Kovács Tímea  
Péter Gabriella dhe Péter Zsolt

Makai István dhe Makai Istvánné  
Mészáros Istvánné  
Futaki Gáborné  
Csehi Attiláné dhe Csehi Attila  
Simon János  
Siposné Hirsch Judit dhe Sipos Ernő  
Szabó Péter  
Pápai Zita  
Lukács László György  
Oláh Gábor  
Mrakovics Szilárd dhe Csordás Emőke  
Kárpáti Zoltánné dhe Kárpáti Zoltán  
Rác Zoltán dhe Rác Gabriella  
Dr. Kiss Ferenc dhe Dr. Nagy Ida  
Túri Lajos dhe Dobó Zsuzsanna  
Jozó Zsolt dhe Molnár Judit  
Mentes Gábor dhe Mentésné Tauber Anna  
Greksa Zsolt dhe Greksáné Martin Mónika  
Mészárosné Varga Márta dhe Mészáros István  
Németh Sándor dhe Némethné Barabás Edit  
Fittler Diána  
Horváth Lászlóné dhe Horváth László  
Varga Andrea  
Téglás Gizella  
Kárpátné Novák Ágnes  
dhe Kárpáti József  
Vargáné Házi Ildikó dhe Varga Mihály  
**Vanyáné Dánffy Beáta dhe Vanya László 5562,1 %**  
Gerő János dhe Gerőné Jócsák Julianna Katalin



## Serbia:

Petrović Dr. Aleksandar dhe Djuknić Petrović Mirjana



## Kroacia:

Kraljić-Pavletić Jadranka dhe Pavletić Nenad



# CONQUISTADOR CLUB 2008



# CONQUISTADOR CLUB 2008



Shumë njerëz i shtrojnë  
vetvetes pyetjen: A jam i aftë  
unë të ndërtoj biznesin FLP?  
Përgjigjja është e thjeshtë:  
Natyrisht, pasi kushdo është i aftë!



# Kush tjetër përveç **teje?**

**K**ështu është me të vërtetë?  
Dhe nëse po, përse nuk e  
bëjnë të gjithë këtë?

Apo ndoshta s'janë të gjithë  
të aftë. Por Ti je! Paradox?  
Ndoshta, por kujt i intereson?  
Atëherë çfarë dëshiron të  
dëgjosh? Që Ti s'je i aftë? Në  
rregull: TI NUK JE I AFTË PËR  
KËTË! Tani je i kënaqur? Përse  
e them këtë? Përse, më parë  
s'deshe të thojë që Ti s'je i aftë?  
E dëgjove, çfarë dëshiron më?  
Shko, shfleto Rosën ose ndonjë  
gjë që është për Ty!!

Tani inatosesh? Atëherë  
fillimi s'bënte fjalë për Ty! Ta  
fillojmë nga e para.

Pra je i aftë për të. Kështu  
e lamë. Atëherë çfarë të  
tërheq prapa që të ngjitesh në  
nivelin e **Jozsi Szabo-s, Miki**

**Berkics-it, Robi Varga-s, Ai  
Vagasi-t** apo **Adolf L. Ko-  
sa-s**? Para se të flas përsëri  
djalli i vogël, ta sqarojmë pak:  
Vetëm **Jozsi Szabo** e nisi nga  
fillimi, të tjerët jo! **Adolf** ishte i  
80 000-ti në Hungari, kurse sot  
ndodhet në top 10!

Mos më hajde me atë  
që Ai ishte i famshëm dhe i  
suksesshëm! Nga njëra anë  
sepse edhe Ti mund të ishe  
po të bëje atë që bënte Ai, nga  
ana tjetër sepse Atij i thonë  
të gjithë që: unë nuk jam aq i  
suksesshëm sa Ti, unë s'mund  
ta bëj këtë! Këtu merr fund  
gjithçka – edhe rrjeti...

Shiko! Ç'do ndodhte  
nëse për një periudhë t'i lije  
pretekstet dhe dyshimet, dhe  
të më kushtojë vëmendje

vetëm mua? Sepse po do ta  
dish – nëse të intereson me  
të vërtetë – ta tregoj se si  
funksionon e gjithë kjo.

Pra, duhet ta vendosësh  
se PËRSE e bën – nëse e bën  
me të vërtetë, ke menduar  
ndonjëherë se sa para duhet  
të bësh nga marketingu  
Network që të jesh i gatshëm  
ta mësosh dhe ta bësh? Dhe  
përse të duhen aq para?  
Do lije vendin e punës?  
Apo do ndryshojë makinën,  
apartamentin? Ndoshta vetëm  
frigoriferin apo lavatriçen?  
Vetëm kaq shpreson? S'ka  
problem! Në errësirë llampa  
e makinës ndriçon vetëm  
100 m, vetëm kaq shikon, por  
rapë mbërrin në shtëpi! Ta  
dish PËRSE!

Me CILIN do punoje me  
dëshirë? Dhe cilët të jenë  
„blerësit” e tu? Besoj se do  
punoje me dëshirë me miqtë,  
nja dy të afërm dhe disa të  
njohurit e tu. Por Ata ndoshta  
jo... Kurse fakti që cilët blejnë  
produkte FLP në bazë të  
fjalëve të tua ka rëndësi. S'kam  
shumë armiq – shpresoj – por  
po të ishin të gjithë „tek unë”  
s'do ishte problem! Që të dish  
se CILËVE u intereson më e  
thjeshta është t'i pyesësh.  
Marrëzia më e madhe është  
nëse vendos në vend të tyre.  
Por për çfarë do vendosje Ti?  
Që s'duan ta heqin nga puna?  
Apo që ajo s'do marrë fund?  
Edhe Ai s'e di, Ti nga ta dish?  
Apo që e ka fëmijën alergjik,  
gjyshin diabetik? Apo që do



fillonte me dëshirë diçka të re? Apo që do bëhej i pasur si **Attila** dhe **Kati Gidofalvi**? Qetësohu, ky s'është problemi Yt! Vetëm shkruaj një listë me Ta dhe filloni të bisedoni!

E di çfarë? FTOJ! Ata për një bisedë shoqërore në një kafene ose në apartamentin tënd. Ose edhe më shumë. Këtë mund ta bësh apo jo? Fton njerëz në dasma, mbrëmje shtëpie apo kinema? Kjo është e thjeshtë, sepse njerëzit i pëlqejnë ato? Pse shëndetin, bazën materiale, pasurinë s'e pëlqejnë? Sepse që ta dish, për këtë të ftojme...

Foli atyre rreth biznesit, produkteve, mundësive, TREGOJU atyre çfarë ke në dorë! S'di ta tregosh? Prit, po përpiqem të ndihmoj. Unë në vendin tënd to thoja që: Gëzohem që erdhe, jam i sigurt që do ketë vlerë koha që kalojmë së bashku. Ekziston një firmë Amerikane e cila kryeson tregun e plotësuesve ushqimor. Produktet e saj kryesore janë pijet e përgatitura nga bima mjekësore Aloe Vera, por kanë edhe plotësues të tjerë ushqimor, produkte higjienike dhe kozmetike. Aloe, sepse kjo është bima mjekësore më komplekse e tokës, por mendoj se këtë e ke të qartë. Nëse jo, atëherë ta dish se përmban afërsisht 240 komponent me rëndësi jetike. Vitamina, lëndë minerale, aminoacide, etj. Pastron, ushqen dhe normalizon funksionet jetike, siç deklarohet edhe një nga mjeket më të shkëlqyera të FLP-s, **Dr. Terezia Samu**. Kjo në rrethanat e sotme, në ushqimin dhe mënyrën e sotme të jetesës është e domosdoshme, mendoj këtë e di edhe Ti. Ruajtja e shëndetit është e rëndësishme, sepse unë njoh vetëm njerëz të sëmurë të cilët para se të sëmureshin ishin të shëndetshëm. Dhe nëse dikush është i sëmurë, pranë trajtimit mjekësor është i rëndësishëm ushqimi! Ky është një katalog, çfarëdo pyetje të kesh në lidhje me produktet e diskutojmë. Jemi dakort që ka shumë njerëz të sëmurë dhe që ushqehen në mënyrën jo të duhur? Mendoj se edhe Ti përdor xhel dushi, pastë

dhëmbësh, dezodor, ndoshta lëndë kozmetike apo pi ndonjë vitaminë. Provoji të tonat, sepse kanë cilësinë më të lartë me çimim të arsyeshëm. Nëse kanë efekt, ndihmo miqtë, të afërmit dhe të njohurit e tu që edhe Ata t'i njohin. Nëse s'ke dëshirë, s'ka nevojë. Por nëse i ndihmon, kjo firmë amerikane ta paguan në mënyrë amerikane punën tënde reklamuese dhe marketing! Nëse të intereson ta tregoj me dëshirë se si mund t'i marrësh falas produktet e tua, si mund të bësh miliona nga disa mijëra forinta. Këto mund të jenë edhe të ardhura pasive, me të drejtë autori. Ty çfarë të intereson më shumë, shëndeti apo paratë? Apo të dyja?

Nëse **PREZANTIMIN** s'e bën dot vetëm – në fillim s'nevojitet – kërko ndihmë nga "sponsori yt".

